

# 3 STRUKTURAT THELBËSORE DISHEPULLIZUESE

Nga TODD MORR



[WWW.MISSIONALMADESIMPLE.COM](http://WWW.MISSIONALMADESIMPLE.COM)

## 3 STRUKTURAT THELBËSORE DISHEPULLIZUESE

Çdo strukturë është unike. Çdo strukturë është thelbësore. Çdo strukturë plotëson të tjerat. Megjithatë, çdo strukturë është e kufizuar në aftësinë për të arritur gjithçka, që nevojitet për ta formuar plotësisht një dishepull.

Gjëra të caktuara ndodhin në çdo strukturë, në nivelin e kokës, zemrës dhe duarve, të cilat mund të ndodhin vetëm në atë ambient unik. Pra, nëse ndonjëra nga tri strukturat mungon apo nuk ka qasje dishepullizuese, atëherë kjo mungesë do të reflektohet në jetët e njerëzve tanë.

### TAKIMET E SË DIELËS

Zakonisht, rreth 1½ deri në 2 orë takim. Lidhje unike, emocionale, madje edhe dinamika në procesin e të mësuarit, ndodhin kur një grup i madh njerëzish mblidhen për të biseduar, dëgjuar, mësuar, kënduar dhe lutur. Ka më tepër inkurajim, ekzaltim dhe motivim kur një grup i madh njerëzish të një mendjeje përpiqen të mësojnë së bashku si ta duan Zotin dhe të tjerët.

Takimet e së Dieles janë gjithashtu një mundësi ku Bibla mund të mësohet, ku mund të tregohen histori inkurajuese jetëndryshimi, ku mund të flitet për nevojat e komunitetit dhe ku lutjet e përbashkëta mund të përjetohen në mënyra unike dhe të fuqishme. Në një grup të madh ka gjithashtu më tepër dhunti, personalitete të ndryshme, eksperiencë, histori dhe burime, që krijojnë potencial për ndikim më të madh. Takimet e së dieles sigurojnë gjithashtu një kontekst, ku më shumë njerëz mund të shërbejnë dhe mësojnë si t'i përdorin dhuntitë e tyre në mënyra, që nuk mund të ndodhin diku tjetër.

### KOMUNITETI MISIONAL

Ky është një grup dishepujsh, që jetojnë së bashku jetë me përkushtim. Një KM nuk është një takim, por një seri pikash ndërlidhëse dhe përvojash përgjatë javës, që edukojnë një dinamikë familjare, sikurse edhe një stil jetese misionarësh. Ata në KM do të kalojnë më shumë kohë së bashku përgjatë javës se sa të krishterët e zakonshëm, që marrin pjesë në takimin e së dieles dhe studimin biblik.

Jeta në një komunitet misional ka gjithashtu një tjetër cilësi përvojë dhe marrëdhënieje, sepse ndodh në kontekstin e jetesës së zakonshme së bashku dhe është më së shumti praktike se sa formale. Po ashtu, për shkak të numrit të vogël, zakonisht 8-14 të rritur, krijohen marrëdhënie të thella, të cilat nuk mund të krijohen vetëm më takimin e së dieles.

KM-të e shohin njëri-tjetrin si familje, e mbështesin njëri-tjetrin si familje, komunikojnë siç do të bënin me familjet e tyre, i njohin pikat e forta dhe të dobëta të njëri-tjetrit dhe punojnë së bashku për rritjen dhe mirëqenien e KM-së, ashtu siç do të bënte një familje. Ka një nivel tjetër zotërimi dhe përgjegjësie.

Duke qenë se KM-të janë grupe të vogla, ku njerëzit krijojnë marrëdhënie të ngushta dhe janë më të fokusuar në qëllimin e tyre, këto komunitete misionarësh sigurojnë një kontekst më të përshtatshëm dhe krijues për të jetuar në bashkësi me njëri-tjetrin, për të kaluar kohë rreth



tavolinës, në shtëpi, në parqe, kafene dhe vende të tjera të hapura. Po ashtu, duke qenë se këto grupe janë të vogla, edhe organizimi i eventeve bëhet më i lehtë.

Një KM është po ashtu një strukturë kritike dishepullizimi, sepse procesi i dishepullizimit dhe arritja e pjekurisë si ndjekës të Krishtit mund të ndodhë vetëm përmes modeleve të mira dhe përvojës. Të dielave dhe gjatë takimeve të DNA-it, formimi shpirtëror ndodh më së shumti në nivelin mendor dhe shpirtëror. Një KM siguron vazhdimisht mundësi për të forcuar besimin dhe për ta vënë në praktikë, ndërsa tregon dashuri e u shërben të tjerëve. Ky është ambienti ku ne jemi "duke vepruar" dhe jo vetëm "duke dëgjuar" gjithçka, që Jezusi na ka inkurajuar ta bëjmë ndërsa e ndjekim atë.

## GRUPET DNA

DNA është akronim në Anglisht për Discover (Zbulohet), Nurture (Eduko) dhe Act (Vepron). Disa kisha përdorin emra të tjerë, si Ungjilli Tripjesësh (Trinjak) dhe Grupet Jetëndryshuese (GJ-të), por funksioni është i njëjtë. Grupet DNA zhvillojnë takime 2 orëshe ose 2 orë e 30 minutëshe. Këto grupe të vogla prej 3-5 grash/vajzash ose 3-5 burrash/djemsh janë unike për shkak të numrit dhe ndarjes sipas gjinisë. Temat e diskutimit në këto grupe janë të ndjeshme dhe kërkojnë thellësi mendimi e kujdes në trajtimin e tyre, ndaj mund të zhvillohen më mirë në grupe të ndara sipas gjinisë.

Për shkak të numrit të vogël të Grupet DNA-it, çdokush ka mundësinë të shprehet dhe të bëjë pyetje, ndaj pjesëmarrja në diskutime është më e madhe edhe duke e krahasuar me komunitete të vogla prej 8-14 të rriturish. Sa më aktiv të jetë çdokush në diskutime, aq më e madhe është mundësia për të zhvilluar mënyrën e drejtë të të menduarit, të folurit dhe lutjes për Ungjillin. Në këtë ambient është thuajse e pamundur "të fshihesh" dhe të mos përfshihesh". Të gjitha llojet e personalitetit, veçanërisht më të qetët, mund të përparojnë, të dëgjohen dhe të njihen nga të tjerët.

## SI MËSOJNË DHE RRITEJN NË PJEKURI NJERËZIT

Ndërsa mendojmë për këto 3 struktura thelbësore dishepullizimi, është e rëndësishme të mbajmë parasysh gjithçka, që dimë për mënyrën se si mësojnë dhe rriten në pjekuri njerëzore. Ja disa parime të rëndësishme për t'i marrë në konsideratë.

Në procesin e të mësuarit dhe zhvilluarit përfshihen këto elemente: elementi i Kokës, elementi i Zembrës dhe elementi i Duarve. Koka lidhet me atë, që ndodh në mendjen e dikujt, pra me mënyrën e të menduarit. Zemra është e lidhur me motivimin/bindjen/qendrën e besimit, që si përfundim përcakton mënyrën si e jetojmë jetën. Ne jetojmë sipas rrjedhës së bindjeve dhe besimeve të zembrës. Duart përcaktojnë se si i vëmë në praktikë bindjet, besimet dhe përparësitë tona. Duart dhe këmbët vënë në praktikë veprimtaritë dhe marrëdhëniet, që ne besojmë se janë më të rëndësishme sipas një perspektive të prirur nga zemra.

Si e ndryshojnë dhe si i japin formë Koka, Zemra dhe Duart një stili jetese të ngjashëm me atë të Krishtit?

- **Mësimdhënia:** E vërteta Biblike, që aplikohet në mënyrë sistematike, në çdo rrethanë dhe hollësi të jetës.



- **Shembujt:** Një stil jetese i ngjashëm me atë të Krishtit, që mund të shihet më nga afër në përditshmërinë.
- **Përvoja:** Mundësi për ta vënë teorinë në praktikë, duke ndjekur modelet e mira.
- **Reflektimi (Trajnimi/Pastorimi):** Diskutimi mbi mësimarrjen përmes të dëgjuarit të së vërtetës biblike, modelimit të kësaj të vërtete dhe përvojës duke e jetuar atë.
- **E mbinatyrshmja:** Shpirti i Shenjtë gjithmonë dëshiron të na ndikojë dhe t'i japë formë mendjes, zemrës dhe duarve. Ai është Shpirti i së Vërtetës që na mëson, rikujton dhe zbulon vazhdimisht të vërteta, që na zhvillojnë mendjen. Ai është Shpirti që na ndryshon zemrat, na bind dhe na këshillon duke na zhvilluar ndjenjat, zemrën. Ai është Shpirti misionar, që na dërgon të duam, t'i shërbejmë dhe t'i shërojmë të tjerët, pra të vëmë teorinë në praktikë.

